



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-05
Vendosi: Gjykatësi i procedurës paraprake
Gjykatës Nikola Giju
Administratore: Dr. Fidelma Donlon
Data: 12 qershor 2020
Gjuha: Anglishte
Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i

Vendimit mbi kërkesën për lëshimin e fletarrestimit dhe urdhrin të transferimit

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit

Julius von Bone

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenet 35(3), 39(3), 41, 53, 54 dhe 55 Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 50, 53, 55, 86(6)(b) dhe 208(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 14 shkurt 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) parashtrori për konfirmim një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, së bashku me materialin provues mbështetës të pretendimeve faktike dhe një përmbledhje të detajuar ku tregohet lidhja e çdo prove me secilën akuzë.²

2. Më 28 shkurt 2020, gjykatësi i procedurës paraprake urdhëroi ZPS-në që deri më 18 mars 2020 të parashtronte, ndër të tjera, një aktakuzë të rishikuar.³

3. Më 18 mars 2020, ZPS-ja parashtrori aktakuzën e rishikuar për konfirmim.⁴ Aktakuza e rishikuar për herë të dytë u parashtrua më 20 mars 2020 (“Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë”).⁵

¹ KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesave në lidhje me të (“Parashtrimi i Parë”)*, 14 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-05, F00003, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Urdhër Prokurorit të Specializuar në bazë të rregullës 86(4) të Rregullores*, 28 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁴ KSC-BC-2020-05, F00004, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për konfirmim dhe kërkesave në lidhje me të (“Parashtrimi i Dytë”)*, 18 mars 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* me shtojcat 1 dhe 2 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁵ KSC-BC-2020-05, F00005, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për Herë të Dytë për konfirmim (“Parashtrimi i Tretë”)*, 20 mars 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* me shtojcën 1 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

4. Më 26 maj 2020, gjykatësi i procedurës paraprake lëshoi një urdhër në të cilin caktohej data e synuar për nxjerrjen e vendimit mbi Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë.⁶

5. Më 10 qershor 2020, Kryetarja nxori vendimin për caktimin e vendit të zhvillimit të procesit në Holandë ("shteti pritës").⁷

6. Më 12 qershor 2020, gjykatësi i procedurës paraprake konfirmoi Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë ("Vendimi i Konfirmimit").⁸

II. PARASHTRIMET

7. Krahas konfirmimit të Aktakuzës së Rishikuar, ZPS-ja kërkon, ndër të tjera, arrestimin dhe transferimin e Salih Mustafës ("z. Mustafa").⁹ Në lidhje me këtë, ZPS-ja pohon se janë përmbushur kushtet e përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit.¹⁰ ZPS-ja pretendon se ekziston dyshim i bazuar se z. Mustafa ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.¹¹ ZPS-ja më tej parashtron se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se z. Mustafa (i) mund të arratiset;¹² (ii) mund të pengojë ecurinë e procedimit penal, ndër të tjera përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit;¹³ dhe (iii) mund të përsërisë veprën penale ose të kryejë vepër tjetër penale.¹⁴

⁶ KSC-BC-2020-05, F00006, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Urdhër për caktimin e datës së synuar për një vendim sipas nenit 39(2)*, 26 maj 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁷ KSC-BC-2020-05, F00007, Kryetarja, *Vendim për caktimin e vendit të zhvillimit të procesit në shtetin pritës ("Vendim për caktimin e vendit të zhvillimit të procesit në shtetin pritës")*, 10 qershor 2020, konfidencial dhe *ex parte*.

⁸ KSC-BC-2020-05, F00008, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Vendim për konfirmimin e aktakuzës kundër Salih Mustafës ("Vendimi i Konfirmimit")*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁹ Parashtrimi i Parë, para. 4, 17-21, 24(ii). ZPS-ja përfshin argumentet e veta në Parashtrimin e Parë me anë të referencave, pjesa B(5)-(6), *shih* Parashtrimi i Dytë, para. 7, 24(b). *Shih gjithashtu*, Parashtrimi i Tretë, para. 3.

¹⁰ Parashtrimi i Parë, para. 5.

¹¹ Parashtrimi i Parë, para. 5(i).

¹² Parashtrimi i Parë, para. 5(ii), 6-7.

¹³ Parashtrimi i Parë, para. 5(ii), 8-11.

¹⁴ Parashtrimi i Parë, para. 5(ii), 12.

8. ZPS-ja gjithashtu kërkon që fletarrestimi t'i transmetohet ZPS-së dhe të zbatohet prej ZPS-së në bashkëpunim me Administratoren.¹⁵ Për zbatimin e fletarrestimit, ZPS-ja kërkon autorizim që ta bëjë të ditur fletarrestimin për aq sa është e nevojshme.¹⁶

9. Për s i përket transferimit të z. Mustafa, ZPS-ja kërkon që gjykatësi i procedurës paraprake të urdhërojë transferimin e tij në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në shtetin pritës, në përputhje me rregullën 50(1) të Rregullores.¹⁷

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Në bazë të nenit 39(3) të Ligjit dhe rregullës 86(6)(b) të Rregullores, me kërkesë të Prokurorit të Specializuar, gjykatësi i procedurës paraprake mund të lëshojë urdhra dhe fletarrestime nëse është e nevojshme për përgatitjen e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë.

11. Sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit, para se të mund të lëshohet një fletarrestim, ZPS-ja duhet së pari të demonstrojë se ekziston dyshim i bazuar se personi përkatës ka kryer veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara. Së dyti, ZPS-ja duhet të provojë se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se së paku ekziston njëra prej tri arsyeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, përkatësisht se personi në fjalë (i) mund të arratiset; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat apo do të pengojë ecurinë e procedimit penal nëpërmjet ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat apo bashkëkryesit; ose (iii) do të përsërisë veprën penale, do të çojë deri në fund kryerjen e një veprë penale të tentuar, ose do të kryejë një veprë penale që ka kërcënuar se do ta kryejë. Së fundi, sipas nenit 41(1), (4), dhe (5) të Ligjit, lëshimi i fletarrestimit duhet të jetë në përputhje me të drejtat themelore të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës, dhe personi përkatës duhet të informohet për të drejtat

¹⁵ Parashtrimi i Parë, para. 17-18.

¹⁶ Parashtrimi i Parë, para. 19.

¹⁷ Parashtrimi i Parë, para. 20.

që gëzon në bazë të Ligjit, në mënyrë që t'i ushtrojë këto të drejta para gjykatësit të procedurës paraprake.

12. Në përputhje me rregullën 53(2) të Rregullores, fletarrestimi përmban informacionin në vijim: (i) emrin dhe mbiemrin e personit dhe të dhëna të tjera identifikuese; (ii) veprat penale konkrete mbi bazën e të cilave kërkohet arrestimi i personit; (iii) paraqitje të shkurtër të fakteve të cilat pretendohet se përbëjnë këto vepra penale; dhe (iv) nëse është e zbatueshme, objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në të cilin personi do të transferohet. Rregulla 53(3) e Rregullores përcakton se fletarrestimi mbetet në fuqi deri në një urdhër tjetër të panelit.

13. Pas lëshimit të një fletarrestimi nga Dhomat e Specializuara, në përputhje me nenin 55 të Ligjit dhe rregullat 50(2) dhe 208(1) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake mund të kërkojë transferimin e atij personi prej autoriteteve kompetente të një shteti të tretë në Dhomat e Specializuara në bazë të një marrëveshjeje të atij shteti me Dhomat e Specializuara, të një marrëveshjeje të atij shteti me Kosovën, ose në bazë të reciprocitetit. Për më tepër, sipas rregullës 55(3) të Rregullores, kur fletarrestimi është në lidhje me një person, vendndodhja e të cilit është ose dihet se ka qenë së fundi në një shtet të tretë që ende nuk ka marrë përsipër obligimin e dhënies së ndihmës, kërkesën për bashkëpunim së bashku me fletarrestimin Administratori ua transmeton autoriteteve kompetente të atij shteti.

14. Neni 35(3) i Ligjit përcakton se policia në kuadër të ZPS-së ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që ka policia e Kosovës në bazë të legjislacionit të Kosovës.

15. Në përputhje me rregullën 55(4) të Rregullores, pasi të jetë informuar për arrestimin nga autoritetet kompetente përkatëse, Administratori bën përgatitjet e nevojshme për transferimin pa vonesë të personit të arrestuar në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, në bashkëpunim me autoritetet kompetente dhe me shtetin pritës.

16. Sipas nenit 41(7) të Ligjit, personat që janë objekt i fletarrestimeve mund të paraburgosen në objekt paraburgimi të mbikëqyrur nga Dhomat e Specializuara dhe të administruar nga Zyra Administrative në afërsi të selisë së Dhomave të Specializuara në shtetin pritës, në qoftë se proceset gjyqësore janë zhvendosur në shtetin pritës.

IV. DISKUTIM

A. JURIDIKSIONI

17. ZPS-ja kërkon lëshimin e një fletarrestimi dhe urdhri të transferimit për z. Mustafa, shtetas i Kosovës, për vepra penale bazuar në nenin 14(1)(c) të Ligjit, të kryera në Kosovë në prill 1999.¹⁸ Gjykatësi i procedurës paraprake rikujton konstatimet e tij për përmbushjen e kushteve të juridiksionit lëndor, kohor dhe territorial përcaktuar në nenet 6-8 të Ligjit.¹⁹

B. KUSHTET E NENIT 41(6) TË LIGJIT

1. Krimet që pretendohet se janë kryer

18. Gjykatësi i procedurës paraprake rikujton se kur konfirmoi Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë, ai konstatoi se ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Mustafa ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, përkatësisht krimet e luftës të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme në shkelje të nenit 14(1)(c) të Ligjit.²⁰ Rrjedhimisht, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton përmbushjen e këtij kushti të nenit 41(6)(a) të Ligjit.

2. Domosdoshmëria e arrestimit

¹⁸ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 1, 35.

¹⁹ Vendimi i Konfirmimit, para. 32.

²⁰ Vendimi i Konfirmimit, para. 123, 129, 133, 138, 141, 145, 151.

19. ZPS-ja parashtron se arrestimi i z. Mustafa është i domosdoshëm duke qenë se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se të tre rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit janë të pranishme.²¹ Gjykatësi i procedurës paraprake rikujton se për përcaktimin e këtyre rreziqeve nevojitet të vlerësohet mundësia e këtyre rreziqeve përkundrejt pashmangshmërisë së materializimit të tyre.²²

20. Për sa i përket rrezikut të arratisjes, gjykatësi i procedurës paraprake gjykon se (i) vënia në dijeni e z. Mustafa për akuzat e paraqitura në aktakuzën që do të dorëzohet dhe dënimet e mundshme;²³ (ii) dijenia e tij për vendimet e fajësisë penale të komandantëve të lartë të Zonës Operative të Llapit për vepra penale të ngjashme që janë bërë të ditura publikisht;²⁴ (iii) fakti se ai aktualisht punon në [REDAKTUAR] të Ministrisë së Mbrojtjes të Kosovës dhe rrjedhimisht ka qasje në informacion dhe mjete;²⁵ dhe (iv) mundësia e tij për të udhëtuar lirisht në shtete të tjera pa nevojë për vizë, demonstrojnë se ai ka motivin dhe mundësinë për t'u arratisur.²⁶ Për më tepër, gjykatësi i procedurës paraprake vë në dukje parashtrimet e ZPS-së në lidhje me mungesën e arsyeve fizike apo shëndetësore që do ta lidhnin z. Mustafa me vendbanimin e tij.²⁷

21. Për sa i përket pengimit të procesit nëpërmjet ndërhyrjes ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, gjykatësi i procedurës paraprake gjykon se [REDAKTUAR], z. Mustafa mund të [REDAKTUAR].²⁸ [REDAKTUAR].²⁹ Për më tepër, [REDAKTUAR].³⁰

²¹ Parashtrimi i Parë, para. 5(ii).

²² Ngjashëm, ICC/GJPN, *Prosecutor v. Bemba Gombo et al.*, ICC-01/05-01/13-558, Dhoma e Apelit, [*Judgment on the appeal of Mr Aimé Kilolo Musamba against the decision of Pre-Trial Chamber II of 14 March 2014 entitled "Decision on the 'Demande de mise en liberté provisoire de Maître Aimé Kilolo Musamba'"*](#), 11 korrik 2014, para. 107.

²³ Parashtrimi i Parë, para. 6; Vendimi i Konfirmimit, para. 163.

²⁴ Parashtrimi i Parë, para. 6; Kosovë, Gjykata Themelore e Prishtinës, *Prokurori kundër R. Mustafa dhe të tjerëve*, P 448/2012, Aktgjykim, 7 qershor 2013.

²⁵ Parashtrimi i Parë, para. 7; [REDAKTUAR], pjesa 1, f. 5.

²⁶ Parashtrimi i Parë, para. 7.

²⁷ Parashtrimi i Parë, para. 7.

²⁸ Parashtrimi i Parë, para. 10.

²⁹ Parashtrimi i Parë, para. 11; [REDAKTUAR].

³⁰ Parashtrimi i Parë, para. 10.

[REDAKTUAR].³¹ Për këtë arsye, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se z. Mustafa ka motivin, mjetet dhe mundësinë për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve dhe viktimave, dhe për rrjedhojë për të penguar ecurinë e procedimit penal.

22. Në lidhje me mundësinë e kryerjes së veprave penale të tjera, gjykatësi i procedurës paraprake thekson raportet sipas të cilave [REDAKTUAR], z. Mustafa është mburrur publikisht për ekzekutimin e serbëve, çka demonstroi një rrezik të mëtejshëm të përdorimit të mundshëm prej tij të dhunës fizike ose kërcënimit për përdorimin e dhunës fizike kundër viktimave dhe dëshmitarëve.³²

23. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se ekzistojnë rreziku i arratisjes së z. Mustafa, i pengimit prej tij të ecurisë së procesit përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët ose viktimat, apo i kryerjes së veprave penale të tjera, çka e bën të domosdoshëm arrestimin dhe paraburgimin e tij në përputhje me nenin 41(6)(b) të Ligjit.

C. PËRPUTHSHMËRIA ME TË DREJTAT THEMELORE

24. ZPS-ja parashtron se gjatë zbatimit të fletarrestimit do të merren masat e duhura për mbrojtjen dhe respektimin e viktimave dhe dëshmitarëve përkatës dhe të të drejtave themelore të z. Mustafa.³³ Meqenëse ZPS-ja zotohet të ndërmarrë masa të tilla, gjykatësi i procedurës paraprake gjykon se asgjë në kërkesën e ZPS-së për lëshimin e një fletarrestimi dhe urdhri për transferim nuk është *prima facie* në mospërputhje me të drejtat themelore të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, në përputhje me nenin 41(4) dhe (5) të Ligjit dhe rregullën 55(6) të Rregullores, z. Mustafa duhet të informohet për të gjitha të drejtat që gëzon në bazë të Ligjit posa të paraburgoset dhe ndodhet nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara, me qëllim

³¹ Parashtrimi i Parë, para. 10.

³² Parashtrimi i Parë, para. 12; [REDAKTUAR].

³³ Parashtrimi i Parë, para. 18.

ushtrimin e këtyre të drejtave para gjykatësit të procedurës paraprake sa më shpejtë që të jetë e realizueshme.

D. URDHËR PËR TRANSFERIM NË OBJEKTIN E PARABURGIMIT TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA

25. Për arsye të sigurisë dhe të administrimit të duhur të drejtësisë, ZPS-ja ka kërkuar caktimin e vendit të zhvillimit të procesit gjyqësor në shtetin pritës, në përputhje me nenin 3(8)(a) të Ligjit.³⁴ Duke marrë parasysh këtë ndryshim të vendit të zhvillimit të procesit,³⁵ gjykatësi i procedurës paraprake e gjykon të domosdoshme që z. Mustafa të transferohet në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, të administruar nga Administratorja, në shtetin pritës. Në përputhje me nenin 41(7) të Ligjit dhe rregullën 55(4) të Rregullores, Administratorja zbaton urdhrin për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në shtetin pritës dhe bën përgatitjet e nevojshme praktike për transferimin e menjëhershëm të z. Mustafa.

E. ZBATIMI DHE DORËZIMI I URDHRAVE

26. Në bazë të nenit 35(3) të Ligjit, policia në kuadër të ZPS-së ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që ka policia e Kosovës në bazë të legjislacionit të Kosovës. Për këtë arsye, ZPS-ja mund të konsiderohet "autoritet kompetent" sipas rregullës 49(1) të Rregullores, e aftë për zbatimin dhe dorëzimin e urdhrave të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat edhe të fletarrestimit bashkëlidhur këtij vendimi.³⁶ Në përputhje me rregullën 49(1) të Rregullores, Administratorja

³⁴ Parashtrimi i Parë, para 3, 20.

³⁵ Vendim për caktimin e vendit të zhvillimit të procesit në shtetin pritës, f. 3.

³⁶ Me informimin e Prokurorit të Specializuar për këtë vendim dhe dy shtojcat e tij nëpërmjet sistemit elektronik *Legal Workflow*, transmetimi i dokumenteve përkatëse Prokurorit të Specializuar konsiderohet i kryer, në përputhje me rregullat 49(1) dhe 55(1) të Rregullores.

transmeton urdhrin për transferim në bashkëpunim me ZPS-në. ZPS-ja mund, sipas rastit dhe nevojës, ta bëjë të ditur fletarrestimin për nevojat e zbatimit të tij.

27. Në rast se ZPS-ja informohet për ndonjë udhëtim të z. Mustafa, të planifikuar apo aktual, apo se z. Mustafa ndodhet në territorin e një shteti të tretë, këtë informacion ia përcjell Administratores pa vonesë. Në qoftë se Administratorja merr një informacion të tillë nga ndonjë burim tjetër që nuk është ZPS-ja, këtë informacion ia përcjellë ZPS-së pa vonesë. Administratorja në vijim dhe pasi të jetë këshilluar me Prokurorin e Specializuar ua përcjell fletarrestimin dhe urdhrin për transferim bashkëlidhur këtij vendimi autoriteteve kompetente të shtetit të tretë përkatës, në përputhje me nenin 55 të Ligjit.

28. Pas mbërritjes nga Kosova në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe gjithsesi para paraqitjes së parë të z. Mustafa, Administratorja i paraqet gjykatësit të procedurës paraprake një raport lidhur me arrestimin dhe transferimin e tij, duke përfshirë të dhënat dhe informacionin përkatës të marrë nga ZPS-ja. Në rast se arrestimi i z. Mustafa kryhet në territorin e një shteti të tretë, Administratorja përgatit dhe paraqet një raport lidhur me çfarëdo veprimi që ka të bëjë me atë shtet, ose çfarëdo informacioni të mëtejshëm që mund të merret nga shteti i tretë përkatës, duke përfshirë (i) informacionin në lidhje me bazën mbi të cilën ai shtet i tretë ka bërë marrëveshje ose mund të ketë marrë përsipër obligimin e dhënies së ndihmës Dhomave të Specializuara; dhe (ii) të gjitha të dhënat dhe informacionin përkatës të marrë nga autoritetet kompetente të shtetit të tretë dhe/ose ZPS-së.

V. VENDIM

29. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i procedurës paraprake:

- a. **MIRATON** kërkesën për lëshimin e fletarrestimit (shtojca 1);
- b. **MIRATON** kërkesën për lëshimin e urdhrin për transferim (shtojca 2);

